

Teksti dhe konteksti në gjuhën e veprës së Ernest Koliqit

Mr. Haki Hysenaj

27 gusht 2008

Përmbledhje

Studimi i teksteve letrare nga anë e aspekte te ndryshme gjuhësore ka filluar shumë vonë te ne, por që në këto vitet e fundit ka zënë të shënojë rezultate të shënueshme nga studiues të ndryshëm.

Në këtë shkrim autori ka vënë në spikamë tekstin dhe kontekstin në gjuhën e veprës së Ernest Koliqit, duke e vështruar nga shumë aspekte.

Ndonëse e adresuar për njësi më të vogla gjuhësore thënia e Sosurit se dëshmia e shkrimit ka vlerë vetëm me kusht që të interpretohet¹, kujtoj se është çelës për çdo lloj analize gjuhësore. Pra, edhe për analizën e tekstit.

Interpretimi gjuhësor nënkupton shumë rrafshë, që janë pjesë e arkitekturës së një teksti të shkruar, çfarë do qoftë ai, pavarësisht zhanrit, gjinisë.

Dhe **gjuhësia tekstore**, ose thënë ndryshe **gramatika e tekstit**, na mëson se, jo vetëm nga Sosyri, por edhe nga studiues shkollash të tjera linguistike, një tekst letrar, qoftë në poezi ose në prozë, mund të kapet e të analizohet nga kënde të ndryshme.

Natyrisht, kur flitet për tekstin si ndërtim, është fjala për tekstin letrar, para studiuesit dalin shumë dilema. E para lidhet me përzgjedhjen. Dhe këtu shtrohet pyetja se çfarë duam të interpretojmë nga gjuha e veprës së një shkrimtari. Prandaj, hulumtuesi mund të lëkundet midis përzgjedhjes së korpusit të njërive tekstore, në njërin anë dhe interpretimit të tyre, në anën tjetër.

Përzgjedhja determinon interpretimin.

Në rastin tonë, qëllim është hulumtimi i ndërtimit të tekstit të **Ernest Koliqit**, ose thënë më saktësisht objekt analize janë dy segmente në lidhje koherente midis tyre, teksti dhe konteksti gjuhësor, vështirësitë dalin e bëhen më të theksueshme.

Vetvetiu sërish shtrohet pyetja tjetër: cila është baza e këtij konstatimi? Përgjigjet janë të shumta. Në do të përmendim vetëm njërin. Kryesoren.

Krijimtaria e Koliqit u takon dy periudhave të ndryshme kohore. E para shtrihet deri në Luftën e Dytë Botërore, ndërsa e dyta rrumbullakon tri decenie pas saj, kohë në të cilën autori boton romanin "*Shija e bukës së mbrumë*", novelën "*Pasçyrat e Narçizit*" dhe shkrimet të tjera për letërsinë dhe kulturën përgjithësisht.

¹Ferdinand de Sosyr, *Kurs gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1997, f. 79.

Kjo ndarje e krijimtarisë së tij letrare, e kushtëzuar nga situatat e krijuara, nuk do mend se ka lënë gjurmë në krijimtarinë letrare të Ernest Koliqit dhe në ligjërimin e tij të shkruar. Gjurmët hetohen jo vetëm në aspektin e përzgjedhjes së temave, ideve, motiveve, formës së ligjërimin por dhe në natyrën e ndërtimit të tekstit. Prandaj, mund të thuhet se të gjitha së bashku, shikuar nga perceptimi psikologjik, mbërrijnë shkallë-shkallë në vizionaritetin simbolist², që kërkon interpretim shkencor.

Këtu kemi të bëjmë në radhë të parë me dinamikën e tekstit. Dhe teksti i Koliqit ka dinamikë ngjitëse dhe zbritëse. Opozicioni del i kushtëzuar nga dy periudhat e përmendura pak më parë: nga periudha e qëndrimit dhe e shkrimit në atdhe dhe nga periudha e qëndrimit dhe e shkrimit larg atdheut.

Në aspektin letrar këto variacione bëhen çështje të kritikës letrare, ndërsa shikuar nga këndi gjuhësor, dinamika bashkë me kohezionin dhe koherencën, si nocione a terma arkiteksti, nuk lënë shumë hapësirë interpretimi.

Koliqi, qysh në fazën e parë të krijimtarisë së tij, kishte krijuar një stil të vetin në përdorimin e shenjave gjuhësore të niveleve të ndryshme edhe për efekte stilistike, por edhe për *arkitektin*. Ato, pavarësisht këtyre periudhave, reflektojnë ngulosje lineare kohezioni e koherence tekstore.

Ndërkaq, konteksti situacional, në këtë periudhën e dytë të krijimtarisë së tij, mund të veçohet nga e para. Tashmë autori në migrim dhe i ekskomunikuar tërësisht, në tekstet e tija të botuara, jo rrallë herë, bën përzgjedhje tjetër.

Këtu mund të flitet posaçërisht për kontekstin e përmendur më sipër. Dhe kjo shihet më së miri në "Pasqyrat e Narçizit". Në këtë novelë autori del përballë 7-të pasqyrave, duke reflektuar në planin letrar referencialitetin simbolik me Mitin e Narcisit, ndërsa në planin gjuhësor një diskurs tjetër nga ai i "Hija e maleve" dhe "Tregtar flamujsh". Kujtim Rrahmani, duke bërë një krahasim midis arkiteksteve të këtyre tri novelave, konstaton: Ecja nga Hija e maleve te Pasqyrat e Narçizit, është ecje nga shkrimi impersonal tek ai personal, për t'i pasur bashkë, të kryqëzuar te Tregtar flamujsh³.

Pra, periudha e dytë, pjesën më të madhe të së cilës autori e kaloi në migrim, në Itali, në një formë a tjetër reflekton këto veçanti ndërtimore në tekstet e letrare të Koliqit. Por ky realitet në këtë rast pasqyron më shumë se motiv e materie për një kumtesë si kjo. Prandaj, konteksti situacional, mbetet një interpretim i dëshirueshëm për ndonjë rast tjetër.

Vetëm shkarazi po përmendim se Koliqi në këtë kontekst shfrytëzon mjetet përkatëse të situacionit, si: përemrat vetorë: unë, ti si dhe elementet gjuhësore që dalin në funksione kohore. Në këtë funksion, si në novelën "Pasqyrat e Narçizit", po ashtu edhe në romanin "Shija e bukës së mbrume" elementet kohore: dikur, këtu, atje, sot, nesër e ndonjë tjetër, që në gramatikën tradicionale emërtohen si ndajfolje kohe, kanë përdorim të dendur dhe funksion të caktuar për ndërtimin e këtij tipi teksti dhe bashkë me te edhe konteksti.

Studiuesi Sabri Hamiti shprehet se modeli shkrimor dhe kulturor i këtij autori është i veçantë në letërsinë shqipe. Duke argumentuar këtë konstatimin Hamiti saktëson se

²Bashota Sali, *Ernest Koliqi-tregimtar i përveçëm*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 22?2, Prishtinë, 2004, f. 208.

³Rrahmani Kujtim, *Interteksti dhe oraliteti*, AIKD, 2018.

në krijimtarinë e tij hetohet këmbëngulja që vlerat e moçme duhet të jenë bazë për çfarëdo rindërtimi të ri krijues, ndërsa nga ana tjetër, shton se shkollimi në Itali dhe kontaktet me krijues eminentë të Evropës kishin bërë që Koliqi të kërkonte një stil të ri të shkrimit letrar. Konstatimi i Hamitit përfundon me thënien se Koliqi kishte arritur të bëjë pajtimin e këtyre dy kërkesave, në dukje, të papajtueshme.

Kujtoj se pikërisht këtu del në pah ndërthurja aq mjeshtërore midis elementeve gjuhësore të tekstit në raport me kontekstin si kuptim, në veprat e këtij shkrimtari. Nuk duhet harruar edhe përkushtimin e tij për të qenë një urë-lidhëse midis diskurseve gjuhësore të shkrimtarëve që i takonin arealit veriorë dhe atyre të arealit jugorë. Prandaj, Koliqi në diskursin e vet ligjërimor nuk kursen përdorimin e fjalëve neolatine dhe turke, për dallim nga pararendësit e tij të Rilindjes. Përdorimi i tyre sa për efekte stilistike aq ndihmon edhe arkitekturën teksture dhe vetë kontekstin ligjërimor të novelave të tij.

Vetë Koliqi, si shkrimtar krijoi një shkrimtari krejt specifike të vetën; mban marrëdhënie të ngushta me folklorin dhe shkruan për shkrimtarë ose dukuri letrare shqiptare.⁴ Konstatimi i Kujtim Rrahmanit⁵: se nëse interteksti, duke hulumtuar ardhjet e teksteve, del përtej kornizave të tekstit, atëherë ky proces kontekstualiteti domosdo që arrin edhe deri te autori, te përvoja dhe intenca e tij që nuk e lënë atë të vdekur, kujtoj se paraqet momentin kulmor kur vetë autori reflekton në kuadër të tekstit dhe të kontekstit të përgjithshëm. Koliqi, i personifikuar me Hilush Vilzën, në artin e vet bëhet pjesë integrale e tekstit dhe e kontekstit të kërkuar këtë herë.

Gjithnjë deri këtu po përmenden elementet ekstralinguistike që ndihmojnë zbërthimin e kompozicionit kontekstual të veprës së këtij autori.

Përshkrimin gjuhësor të një teksti konkret **Rexhep Ismajli** e konsideron të një peshe të veçantë në hulumtimet gjuhësore. Duke u mbështetur në pikëpamjet e semiotikëve letrarë të Parisit (Algirdas-Julien Greimas) Ismajli shpjegon se teksti është një lloj bashkësie e përbërë nga ligjërata dhe rrëfimi, si dhe nga relacionet e vendosura midis këtyre dy elementeve⁶. Çështjet që dalin nga ligjërata shtrohen në gjuhësi, ndërsa të tjerat në semiotikë letrare⁷.

Në gjuhën e veprave të Koliqit, posaçërisht në novelat: "**Hija e maleve**" (1929), "**Tregtar flamujsh**" (1935) dhe në "**Pasçyrat e Narçizit**" (1963), rrëfimi, përshkrimi, dialogu dhe forma të tjera ligjërimore dalin si forma të përdorura dendur, ndërsa në novelën e fundit, narrativja zë vendin qendror, që shikuar nga ana stilistike shquan autorin për një stil sa të veçantë aq edhe të kapshëm për marrësin.

Po, këtu nuk do të flitet për stilin. Përkufizimi i temës përcakton studimin e dy përbërësve të shkrimit të Koliqit, tekstin dhe kontekstin gjuhësor të veprave të tij.

Teorikisht, dy funksionet e gjuhës së shkruar, funksioni i të qenit objekt studimi dhe funksioni si gjuhë e përshkrimit, ndërveprojnë në mënyra komplekse duke e vështirësuar vënien e një kufiri të prerë ndërmjet të dytës dhe të parës⁸. Ky konstatim besojmë se

⁴ Asllani Persida, *Koliqi lexues i De Radës*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë Shqiptare, 23/2, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2004, f. 449.

⁵ Rrahmani Kujtim, *Interteksti dhe oraliteti*, AIKD, 2002.

⁶ Ismajli Rexhep, *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 36.

⁷ Ismajli Rexhep, *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 38.

⁸ Shih: Rugova Bardh, *Gjuha e gazetave në Kosovë*, (disertacion i doktoratës), Prishtinë, 2006. f. 37.

dëshmohej shumë qartë edhe në veprat që kemi objekt trajtimi.

Ndërsa **Umberto Eco** thotë se rregulli kryesor për t'iu qasur një teksti narrativ është që lexuesi të pranojë heshtazi një marrëveshje fiktive me autorin. Kjo sikur ka ndodhur gjatë punës sonë.

Tek tashti kemi rrëshqitur në materialin gjuhësor që Koliqi shfrytëzoi për tekstin e tij.

Koliqi të rrëmben, nëse mund të thuhet kështu, nga dy aspekte, e para: nga shumëllojshmëria e temave, motiveve dhe ideve që ngërthejnë dy profile të autorit, atë të autorit "në fron", siç do ta emërtojë **Kujtim Rrahmani**; dhe e dyta: stili i tij i veçantë me ndërtime shpesh individuale, që Koliqin e bëjnë për shumëçka të veçantë në ngrehinë e quajtur tekst letrar.

Sekuencialja narrative në novelat e përmendura është shkrirë pahetueshëm bashkë me shumëllojshmëritë e tjera sekuenciale, duke bërë tekstin e tij lehtë të kapshëm nga lexuesi edhe në planin kontekstual. Përdorimi i mjeteve të ndryshme gjuhësore për lidhjen e sekuencave të tilla është një mbërritje tjetër e këtij autori, që shquan atë për arkitekturën e tekstit.

Të përkujtojmë se dy novelat e para ndërtohen mbi bazën e tregimeve të ndryshme, të cilat, në aspektin filologjik mbase edhe mund të interpretohen si tekste të veçanta. "Hija e maleve", që në vete ngërthen dymbëdhjetë dhe novela "*Tragtar flamujsh*" gjashtëmbëdhjetë tregime, janë dy shembuj për mundësinë e prerjes së kufirit midis akëcilit tregim. Kjo është mundësia e parë dhe sigurisht më e lehta për t'u realizuar. Por nëse lexohen të gjitha tregimet sipas renditjes dhe nëse njëkohësisht krahas hulumtimit gjuhësor rrëshqitet edhe në planin letrar, duke identifikuar temat e tyre, veçimi bëhet i papranueshëm. Janë temat e përzgjedhura nga autori ato që krijojnë strukturë të pandashme teksti, në njërën anë dhe në anën tjetër, si të tilla, sikur paraqesin një bashkimin organik të një makroteksti, që nuk është tjetër veçse bazë e një kontekstualiteti unik që mundëson dekodimin e parë të veprës letrare.

Dekodimi i dytë është me tepër çështje hulumtimi artistik i një vepre. Megjithatë edhe ky dekodim ka burimin në shprehësinë gjuhësore, si në shprehësit fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore.

Në novelën e parë, "Hija e maleve", në të gjitha tregimet autori përzgjedh tema që kanë gjenezën në moralin e Malësisë dhe të malësorit, duke i shtjelluar tutje ato me gjithë dramacitetin dhe tragjicitetin e tyre edhe në mesin urban. Kjo përzgjedhje del hapur te tregimi "Gjaku" dhe përsëritet herë më e sforcuar e herë më e zbehtë edhe në tregimet e tjera.

Ndërsa në novelën e dytë "Tragtar flamujsh" autori përzgjedh tema dhe motive nga jeta urbane e qytetit të tij të lindjes, duke zbuluar përmes tyre ambicet e njerëzve urban dhe dallimet që ekzistonin midis shtresave të shoqërisë. Ndonëse dinamika tekstore nuk ecën drejt dramacitetit ose edhe tragjicitetit, autori edhe këtu, në çdo tregim veç e veç, trajton gati të njëjtën temë, veçse në forma të ndryshme, duke rrëshqitur ndonjëherë edhe në një ndjenjë humori për realitetin dhe bartësit e tij.

Dhe së fundi gati e njëjta gjë mund të thuhet edhe për novelën "Pascyrat e Narçizit". Vetë shpalosja e identitetit shpirtëror personal në shtatë trajta është fakt i mjaftueshëm për të konstatuar se gjithë novela e përbërë nga shtatë tregime ka një temë të vetme, që shquhet për kohezion dhe koherencë teksture, nga fillimi deri në fund. Konteksti del i

ndërtuar me një shkallë të lartë homogjeniteti. Kalimi nga një tregim në tjetrin përmes fjalëve referenciale dhe kalimtare është i lehtë dhe mbase i pahetueshëm nga marrësi.

Përbërja tematike, tashti në planin gjuhësor, shkon në të mirë të konstatimit se teksti i këtij autori ka një koherencë, gjë që mundëson konstatimin shtesë të ekzistencës së kontekstualitetit, që ndihmon qartë kapjen e mesazhit të bartur përmes shkrimit.

Prandaj, nisur nga ky fakt mund të themi se tashmë është pranuar të jetë tejkaluar nocioni se linguistika kufizon objektin vetëm në kufijtë e frazës. Sipas Cvetan Todorov-it⁹, teksti mund të koincidojë me një frazë ashtu si edhe me një libër të tërë. Për më shumë, që nga shkolla frënge, nënvizohet që fjalitë janë pjesë përbërëse të një njësie superiore, të makrofjalisë, që edhe ajo në vetvete përbën një komponent të sekuencës, e cila është pjesë përbërëse e tekstit¹⁰.

Sipas Jolanda Kostarit¹¹, gramatika e tekstit mundëson interpretimin e fakteve e të kategorive të ndryshme gjuhësore, si. p. sh. anafora, shquarsia, rendi i fjalëve, përdorimi i përemrave, i konektorëve, sistemi foljor, intonacioni, emfaza etj, interpretim që nuk ishte i mjaftueshëm nëse nuk do të mbështetej në strukturën e tekstit në përgjithësi, në kontekstin ligjërimitor e në të dhëna të kontekstit në kuptimin e gjerë të fjalës, pra nëse nuk do të bëhej në kuadrin e kuptimit të përgjithshëm të thënies, rifutja e të cilit (kuptimit) në analizat gjuhësore përbën një nga arritjet më të rëndësishme të gjuhësisë së përgjithshme të kohëve të fundit.

Po sipas saj, gramatika e tekstit në plan të parë ka konceptin e koherencës, e cila është e rëndësishme në atë masë për tekstin, sa është rregullsia gramatikore për frazën¹². Nga ana tjetër studiuesja Linditë Rugova¹³ thotë se nëse kohezioni ka të bëjë me mënyrën se si lidhen gramatikisht njësitë përbërëse të tekstit, atëherë koherenca nënkupton lidhjen logjike të pjesëve të një teksti të shkruar dhe ka të bëjë me kalimin e pavërejtur nga njëra pjesë në tjetrën.

Dy përkufizimet e cekura më lartë, për të njëjtën çështje, i afrohen aq harmonikisht nocionit të kontekstit, për të mos thënë se gati e mbulojë të tërin.

Sipas Tefë Topallit, për gjuhësinë bashkëkohore nocioni i tekstit merret si uniteti themelor i komunikimit verbal; ai konsiston në një mesazh, dhënë nëpërmjet çdo kanali (të shkruar a të folur), që shpreh një temë të lidhur (unitare) në një kuadër të koherencës semantike e kohezionit sintaksor, sipas situatës së aktit të komunikimit. Duke cituar gjuhëtarin italian Ceppellini (shqip=Çepelini) Topalli shton se në anën tjetër konteksti tregon koordinimin e pjesëve të një diskursi, bashkimin organik të një shkrimi, kurorën e tij gjuhësore (fjalët pararendëse e vijuese) dhe jashtëgjuhësore (kuptimet e fjalëve, rrethanat, toni i zërit, roli i bashkëbiseduesit) që ndihmon për të përcaktuar kuptimin e mesazhit¹⁴.

⁹Dykro Osfald-Todorov Cvetan, *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, "Rilindja", Prishtinë, 1984, f. 410.

¹⁰Topalli Tefë, *Gjuha dhe shkrimtari*, Shkodër, 2001, f. 108.

¹¹Shih: Jolanda Kostari, "Gjuha jonë", 1-4/1995, f. 66.

¹²Shih: Jolanda Kostari, "Gjuha jonë", 1-4/1995, f. 66.

¹³Rugova Linditë, *Kohezioni dhe koherenca - realizimi i tyre në gjuhën e shkruar akademike*, Filologji 12, Universiteti i Prishtinës, f. 199.

¹⁴Topalli Tefë, *Gjuha dhe shkrimtari*, Shkodër, 2001, f. 107.

Konstatimi tjetër i gjuhëtarit Rafael Salkie se një tekst, ose një diskurs, është një rrjedhë e gjuhës që mund të jetë më e gjatë se një frazë dhe se në interes të analizës së tekstit dhe të diskursit është të identifikuarit e frazave për formimin e tekstit¹⁵ tejkalon kufijtë e kësaj kumtese.

Megjithatë mund të thuhet se ndërtimet sintaksore në gjuhën e veprave të Koliqit paraqesin një fushë në vete dhe interesante për hulumtim. Te ky autor janë të njohura ndërtime sintagmash e fjalish të ndryshme që nisin me mjete të ndryshme gramatikore. Pjesëzat, posaçërisht pjesëza e, që del edhe në trajta të tjera, përdoret dendur në ndërtimet sintaksore të tij, Sipas Laura Smaqi¹⁶ ato paraqesin një veçanti tejet individuale dhe gjuhësore në arkitekstin koliqian.

Gradualisht po rrëshqasim në nyjëtimin e tretë, që sipas terminologjisë së Martinesë identifikon pikërisht nyjëtimin tekstor, ose thënë ndryshe arkitekstin.

Teorikisht veprat letrare mund të vështrohen nga dy aspekte. E para lidhet me strukturën dhe e dyta me kompozicionin. Kjo vlen në radhë të parë për analizat letrare të tekstit. Mirëpo, siç shprehet Jolanda Kostari¹⁷, gramatika e tekstit bën të mundur lidhjen midis studimeve gramatikore dhe studimeve letrare. Prandaj, për të gjetur kufijtë e një teksti të një makroteksti të caktuar gjithsesi këto qasje dalin në raporte vartësie midis tyre. Vepra letrare ka një temë rreth së cilës shtjellohet gjithë materiali gjuhësor¹⁸.

Siç është thënë edhe një herë, tri novelat e Koliqit kanë strukturë të mbyllur në aspektin ndërtimor. Ndërsa në aspektin perceptues struktura e tyre gjuhësore dhe letrare është e hapur, dhe si e tillë, lë mundësinë për interpretime të ndryshme. Madje, elemente të njëjta gjuhësore mund të interpretohen jo vetëm nga aspekti strukturor por edhe ai funksional, në mënyra të ndryshme. Ky konstatim është rezultat i variantit gjuhësor të përdorur nga Koliqi.

Baza dialektore e gegërishtes veriperëndimore në gjuhën e veprave të tij dhe prirja për shfrytëzimin e elementeve gjuhësore të arealit tjetër, toskërishtes, përdorimi i të cilave në strukturën ligjërimore të tekstit gjuhësisht del shumë i ndërliqshëm, krijojnë mundësinë interpretimit të përmendur më parë.

Nëse do të pranohet si të saktë konstatimin se koherenca e tekstit sigurohet nga të dhënat e kontekstit gjuhësor e të situatës jashtëgjuhësore, në rastin tonë do të thoshim se tri novelat e Koliqit për këto dy elemente reflektojnë pashmangshëm këtë tip ndërtimi.

Teksti koheziv i Koliqit, që në fakt është prirja për mbulimin e termit kontekst, realizohet përmes mjeteve të ndryshme gjuhësore, që jo rrallë herë identifikohen edhe si figura sintaksore.

Këtu do të përmendim anaforën, si një element stilistikor të rëndësishëm në ndërtimin e tekstit koliqian.

P.sh. Dodën e kishte rrëmbye një mëndim i largët qi vajza përpiqej me gjithë fuqin e mëndes me i a lexue në fytyrë, pa pas guximin me pyetë. Instiktivisht, si t'a dronte at heshtje të zgjatuese, n'at gjymsë drite qi kish rrethue tândën e blerë, i'u afrue dhe i'u

¹⁵Salkie Rafael, *Text and Diskurse Analysis*, Language Workbooks, London and New Yourk, 1995, f. 9.

¹⁶Smaqi Laura, *Modele ndërtimore në prozën e shkurtër të Ernest Koliqit*, S.F. ASHSH, Tiranë, 2003, nr. 1-2, f. 203-142.

¹⁷Shih: Jolanda Kostari, "Gjuha jonë", 1-4/1995, f. 66.

¹⁸Rrahmani Zejnullah, *Teoria e letërsisë*, Dukagjini, Pejë, 1999, f. 23.

pushtet në krah, e uli kryet mbi parzëm të tij. Ai e puthi, lehtë, ndër flokë e tha me zâ qi kumboi çuditshëm si t'i dilte nga fundet e pandërgjegjeshme të qënjes...

Tregimi Gjaku (Hija e maleve), f. 21.

Trajtat e shkurtra: i a; i u dhe t'i në këto tri fraza, që dalin si sekuenca të një makroteksti, si dhe përdorimi i përemrit pronor të tij dhe dëftorit ai, gjuhësisht interpretohen vetëm në kuadër të kontekstit të tërë të këtyre frazave sekuenciale.

Tri trajtat e shkurtra përemërore si dhe pronori të tij dhe dëftori ai, që ndeshën në dy thëniet e fundit, i referohen të të njëjtës sekuenca tekstore dhe për më shumë subjektit të njëjtë, Dodës, që në analizën e tekstit ose diskursit identifikohet si paraprijës i rrjedhës ligjërimore dhe vetë vargut të nyjetimit të tretë.

Këto elemente gjuhësore në gramatikën tekstore konsiderohen fjalë referenciale, por që dalin detyrimisht në raporte vartësie kontekstuale. Të përdorura në këto funksione ato barazohen me figurën sintaksore të anaforës. Dhe anafora në këto tri novela realizohet në forma të ndryshme, si naporë konceptuale, asociative...

Elemente, si të parat, në arkitekstin e Koliqit dalin edhe në funksione të tjera. Megjithatë, edhe në këto raste, flitet për përdorime anaforike të tyre. Dhe më tutje, interpretuar nga aspekti teorik, anaforat si këto, por edhe të tjera që në gjuhën e Koliqit realizohen edhe me ndihmën e përemrave vetorë, pronorë, dëftorë e lidhorë, reflektojnë sinjale kohezioni dhe vazhdimësie të tekstit, në njërën anë dhe në anën tjetër identifikohen me shenja gjuhësore që mundësojnë perceptimin e kontekstit të përgjithshëm të një mikro a makroteksti të caktuar.

Nga ana tjetër Koliqi paraqet mjeshttrin e vërtetë të përdorimit të rimarrjes së njërive gjuhësore për të realizuar jo vetëm stil të veçantë, por edhe strukturë tekstore të arrirë gjuhësisht si dhe transmetim mesazhi sa më të qartë në kuadër të kontekstit ligjërimor.

Në gramatikën tekstore rimarrja, e njohur edhe si analepsa¹⁹, konsiderohet si një mjet gjuhësor dhe stilistik që kryen funksion drejtimi a përforsimi të një mesazhi të caktuar. Në tregimin "Gjaku", të novelës "Hija e Maleve", Koliqi këtë mjet e përdor për funksionin e parë, d.m.th. drejtimin e ndërtimit të tekstit. Po nëse shikohet konteksti i gjithë tregimit dhe forma narrative e fillimit dhe e mbarimit të tij del se autori përmbyll të njëjtin qëllimshëm me figurën e analepsës.

P. sh. Æsht përgjegjësi e madhe, pasha Zotin. A po jo?

Vajza as nuk pohoi as nuk mohoi.

Æsht përgjegjësi e rreptë.

Derisa tregimi "Gjaku" nis me shpalimin e misionit të personazhit, Dodës:

A ka send mâ të mrekullueshëm në këtë botë se me i sjellë qytetnîmin nji kombi zhytë n'errsin e padijes?

- përfundon me frazën bashkërenditëse:

Dhe nxuer do tabakë letre e kapi penden për me shkruë.

Midis fillimit dhe fundit të këtij tregimi, të cilin Sabri Hamiti e cilëson të karakterit psikologjik²⁰ ndodhin shumë ngjarje. Por gjithë mesazhi realizohet i tërësishëm me frazën e fundit, kur autori, pavarësisht thyerjeve të mëdha në jetën dhe sjelljen e personazhit të

¹⁹Shih: Salkie Rafael, *Text and Diskurse Analysis*, Language Workbooks, London and New Yourk, 1995

²⁰Hamiti Sabri, *Letërsia moderne shqipe*, Prishtinë, 1999, f. 133.

vet, Dodës, rikthen atë te misioni primar:

Dhe nxuer do tabakë letre e kapi pënden për me shkruar.

Këtu, nëse nuk mund të flitet për një rimarrje besnike të frazës drejtuese, sigurisht se mund të flitet për analepsën që mundëson transmetimin e mesazhit të plotë. Pra, Doda intelektual, me mision të qartë, ndonëse bie viktimë e zakoneve të egra të maleve, nxjerr gjakun e të vëllait, Zekës. I vetëdorëzuar, sërish u kthehet letrave. Sërish i kthehet programit të tij. Por tashti në rrethana dhe situata krejtësisht të tjera. Përmes kësaj rimarrjeje autori rikthen Dodën në misionin e tij që të sjellë qytetnimin e munguar në rrethin e vet. Dhe ky është mesazhi kontekstual i përcjellë me aktin e shkrimit, jo shumë vështirë për t'u dekoduar nga marrësi.

Kompozicioni i fabulës së këtij tregimi realizohet në formë sekuencash.

P.sh. Doda kthehet në atdhe me misionin për të sjellë qytetninë.

Doda dashurohet në Nushën, bashkëvendësen e tij shkodrane.

Doda për një çast gjendet midis misionit të tij dhe ligjeve të ashpra të maleve, pasi merr vesh si ia kanë vlarë vëllain. Nisin dilemat. Në brendinë e shpirtit të tij rishfaqen të ngurosurat e traditës.

Doda ndryshon krejtësisht. Lë librin, ikën gjithnjë e më shumë nga Nusha.

Doda i kthehet pijes. Trandet nga fjalët për gjakun e panxjerrë.

Doda, në një moment krize, gjen armën dhe nxjerr gjakun.

Doda nuk ikën. Vetëdorëzohet. Pendimi nuk i ndihmon.

Në këto rrethana dhe në këtë situatë ai sërish nxjerrë disa tabakë dhe fillon të shkruajë. Megjithëkëtë kthim insistimi i Dodës për transformimin e jetës nuk ndodh.

Të gjitha këto sekuenca kanë një organizim dhe ndërtim koherent. Përmes mjeteve të ndryshme gjuhësore autori realizon artistikisht dhe gjuhësisht një tekst të veçantë në gjithë diskursin e tij.

Ndërtimi i kohezionit të tekstit bëhet me ndihmën e fjalëve të ndryshme referenciale, të cilat në shumicën e rasteve nuk kanë kuptim të mëvetësishëm. Ato dalin të rëndësishme edhe për kalimin nga një sekuencë në tjetrën, duke ndihmuar kështu rrumbullakimin logjik të kontekstit ligjërimit. Krahas tyre Koliqi përdor edhe fjalë kalimtare të tipit: kështu, mbandej, nisi, vijoi nejtë, por, atëherë etj., të cilat mundësojnë një tranzicion të pahetueshëm nga sekuenca në sekuencë për t'u identifikuar kështu si elemente me vlerë të posaçme për kontekstin ligjërimit.

Një formë tjetër shprehëse është edhe digresioni, që përdoret aq shpesh në këto tri novela. Sa herë që paraqitet nevoja për kontinuitetin e tërësishëm të mendimit, që ndonjëherë shpërndahet në sekuenca teksti, autori përdor digresionin si mjet të qëlluar për synimin e vet.

Kështu për të dhënë një sqarim midis dy karaktereve, atë të Gaspër Tragaçit, shitësit të flamujve dhe Hilushit, që është vetë autori si pjesë e intertekstit, Koliqi bën këtë digresion ndërsekuencial:

Djaloshi çuditej vetimeveti për butësin me të cilën epte përgjigje ndërsa në shpirt ndijësia kundërshtare i shndohej n'urrejtje të hovshme.

Novela "**Tregtar flamujsh**", f. 169.

Ernest Koliqi, në tregimet e tij ka të projektuar autorin në tekst, si një vetëdije prej një intelektualit dhe artisti që ka un-in e vet, dhe para së gjithash, identifikohet me kërkesën

e statusit artistik të tekstit letrar, do të thoshte Kujtim Rrahmani²¹, duke aluduar në Hilush Vilzën, alias Koliqin.

Diaskursi i Koliqit nuk del i njëjtë në tri novelat e tij. Në "Hija e maleve" autori anon drejt diskursit autorial. Në "Tregtar flamujsh" hetohet prirja personalizuese, ndërsa në novelën "Pasçyrat e Narçizit" del sheshazi identifikimi i autorit me personazhin kryesor.

Kjo larushi diskursi dhe kodi, pa u thelluar në interpretimin e tij, nuk besoj se lëndon kontekstualitetin e cilësuar deri tashti si të qartë e homogjen. Mesazhi, pavarësisht tipave të diskursit ligjërimit, në të tri novelat e tij del i dekodueshëm dhe i qartë për dekoduesin.

Dhe fare në fund do të thoshim se teksti dhe konteksti i tri novelave të Koliqit: "**Hija e maleve**", "Tregtar flamujsh" dhe Pasçyrat e Narçizit" janë aq të realizueshme artistikisht dhe homogjene për arkitekturën, kohezionin dhe koherencën sa lënë përshtypjen të një makroteksti të hapur për interpretime të ndryshme filologjike, në njërën anë dhe në anën tjetër, të një konteksti të mbërrimë e qartë të kapshëm me të gjitha dimensionet dhe mesazhet që bart.

Natyrisht se pos mjeteve të përmendura në këtë kumtesë, të cilat autori i përdor mjeshhtërisht për të arritur këtë qëllim, ai vë në diskursin e tij shkrimor edhe elemente të tjera, si: përsëritje fjalish, përdorim sinonimesh, fjalë kundërvënëse dhe fjalë relative, të cilat Rafael Salkie²² i quan mjete leksikore të kohezionit leksikor, duke ua shtuar të njëjtave edhe konjunktivët, elipsat, fjalët preferenciale si dhe fjalët zëvendësuese.

Tri novelat e Koliqit, që e ngrenë në nismëtarin e prozës moderne, përfundimisht pasqyrojnë dimensione referenciale, modale dhe pragmatike dhe si të tilla ato bëhen edhe gjedhe për tekste dhe kontekste të arrira nga aspekti gjuhësor dhe letrar.

²¹Rrahmani Kujtim, *Interteksti dhe oraliteti*, AIKD, 2002, f. 42.

²²Shih: Salkie Rafael, *Text and Diskurse Analysis*, Language Workbooks, London and New Yourk, 1995.